



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 127, Datë 25.06.2024

MBI

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“AGE ERZEN” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregulator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.06.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 814/6 prot., datë 21.06.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “AGE ERZEN” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 814/3 prot., datë 31.05.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Hekali”, me kapacitet të instaluar 1940 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 113, datë 10.06.2024, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Hekali”, me kapacitet të instaluar 1940 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë, për arsye se shoqëria nuk kishte kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 10, pikës 7 të Rregullores, duke qenë se subjekti ka kryer pagesën e aplikimit brenda 1 (një) muaji nga marrja dijani e vendimit për mosfillimin e procedurës, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për fillimin e procedurës.
- Po ashtu nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.1, gërmat “a” dhe “b”; për pikën

1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1 gërmat “b”, “c”, “d”, dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “AGE ERZEN” sh.p.k.:
 - ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Kontratën nr. 1655 rep., nr. 367/3 kol., datë 03.12.2020 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin hidrocentralit “Hekal”, me kapacitet 1940 kW, në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë”;
 - është pajisur me Lejen për përdorimin e burimit ujor, lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor (KBU) Erzen, datë 18.09.2020, miratuar me Vendimin e Këshillit të Basenit Ujor nr. 5, datë 16.09.2020, për prodhim hidroenergje nga HEC “Hekali”;
 - ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” marrëveshjen nr. 1966/2 prot., datë 17.04.2020, për lidhjen e HEC “Hekal”, me fuqi 1940 kW, me rrjetin e shpërndarjes;
 - është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më datë 09.06.2022 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi dhe operimi i HEC “Hekal”, me fuqi të instaluar 1940 kW.
- Nga ky aplikimi nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni si vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.1. Shoqëria duhet të depozitojë të plotësuar gërmën “c” të Shtojcës 1.

Pika 2.1

- **gërma “a”:** Shoqëria duhet të përcaktojë kapacitetin e secilës prej turbinave.
- **gërma “e”:** Shoqëria duhet të dokumentojë fillimin e punimeve brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së Paraprake.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Hekali”, me kapacitet të instaluar 1940 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “AGE ERZEN” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI